REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 25.10.2022)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:30 dhe mbaroi në orën 12:55.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
4. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
5. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
6. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
7. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami***, anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Fatmira Luli,*** anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Yllka Rupa,*** si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***z. Dritan Hallunaj.***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ.

5. Vladimir Karaj, BIRN.

6. {...}, Inspektore pranë Zyrës së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

7. {...}, Ndihmësinspektor pranë Zyrës së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

8. Mimoza Koçiu, Këshilltare pranë Zyrës së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë.

9. {...}, magjistrat.

10. Të tjerë: Katerina Çela, Universiteti "Epoka"; Greta.

RENDI I DITËS:

1. Zhvillimi i seancës dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, në detyrën e zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

Ilir Rusi: Përshëndetje!

Për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, mbledhjen e sotme të datës 25 tetor 2022, ora 11:00, e deklaroj të hapur.

Sipas rendit të ditës të njoftuar sot kemi një zhvillim seance dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, në detyrën e zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Referuar autorizimit, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, për këtë seancë dëgjimore, ka autorizuar zonjën {...}.

Prezent?

(Në sallë ndodhet zonja {...}, përfaqësuese nga Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, e shoqëruar nga ndihmësinspektori pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.)

Gjithashtu është njoftuar edhe magjistrati zoti {...}.

Prezent?

(Në sallë ndodhet magjistrati {...}.)

Në vazhdim të procedurës do ftoja palët nëse keni ndonjë kërkesë paraprake apo jo.

Përfaqësuesja e ILD-së?

{...}: Jo, nuk kam asnjë kërkesë.

Ilir Rusi: Magjistrati, z. {...}.

{...}: Asnjë kërkesë.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Atëherë vazhdojmë me parashtrimin e fakteve, duke ia dhënë fjalën përfaqësueses së Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë znj. {...}.

{...}: Faleminderit!

Të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin nr. {...} prot., datë 24.12.2021 ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor mbi bazë ankese ndaj magjistratit {...} me detyrë zëvendëskryetar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronjat "g", "gj", "l" dhe pika 2, shkronja "dh" e ligjit nr. 96/2016 " Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Në analizë të identifikimit të elementeve faktikë dhe juridikë të cilat provojnë, ekzistencën e shkeljes disiplinore, si dhe nuk diktojnë mbylljen e hetimit disiplinor, nga provat e administruara në kuadër të këtij procesi hetimor, rezulton se në rastin konkret për sa i përket shkeljeve disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronjat "g", "gj" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nuk ekziston asnjë rrethanë faktike apo element juridik, i cili dikton mbylljen e këtij hetimi disiplinor nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në mbështetje të parashikimeve të nenit 117, nenit 120, pika 1, shkronja "b", "ç", "d", "dh", nenit 134, pika 1, të ligjit nr. 96/2016.

Ndërsa për sa i përket shkeljeve të tjera të dyshuara disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja "l" dhe pika 2, shkronja "dh" e ligjit nr. 96/2016, në rastin konkret paraprakisht vlerësohet se hetimi disiplinor duhet të mbyllet në mbështetje të parashikimeve të nenit 134, pika 1, shkronja "a" të ligjit nr. 96/2016, për shkak se provat janë të pamjaftueshme për të provuar kryerjen e shkeljes disiplinore.

Nga analiza ligjore e fakteve të konstatuara gjatë hetimit rezulton se nga ana e zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, z. {...} nuk është arritur të justifikohet moszbatimi i vendimit të KLGJ-së nr. 307, datë 13.07.2021 "Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së znj. {...} në pozicionin e kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë" si dhe në 2 mbledhje të njëpasnjëshme të Këshillit të Gjykatës, pra në mënyrë të përsëritur, nuk ka respektuar dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Gjykatës.

Ndërmarrja e këtyre veprimeve nga ana e zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, z. {...}, përbëjnë mospërmbushje të detyrës së zëvendëskryetarit i cili ka përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor duke siguruar mbarëvajtjen dhe funksionimin e gjykatës si institucion.

Në analizë të kriterit të "shkallës së fajësisë dhe motivi", në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor, paraprakisht vlerësohet se në rastin konkret rezulton se shkeljet disiplinore nga ana e zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë z. {...} janë kryer me dashje. Ai edhe pse është njohës i kuadrit ligjor në fuqi që rregullon organizimin dhe funksionimin e gjykatës zgjedh të mos i respektojë ato.

Ndërsa në analizë të kriterit "pasojë e shkeljes", rezulton se si pasojë e veprimeve/mosveprimeve të kryera nga ana e zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ka krijuar konfuzion mbi ushtrimin e kompetencave të kancelares e cila sipas nenit 39 të ligjit 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është përgjegjës për menaxhimin e administrimit gjyqësor dhe në veçanti ka kompetencat e mëposhtme: a) është anëtar me të drejtë vote në Këshillin e Gjykatës, në përputhje me nenin 27, dhe i Komisionit të Ristrukturimit, sipas pikës 6, të nenit 66, të këtij ligji; b) kryen veprime dhe merr vendime që lidhen me statusin e nëpunësve civilë gjyqësorë siç parashikohet në këtë ligj; c) mbikëqyr procesin e organizimit dhe dokumentimit të ndarjes së çështjeve me short; ç) emëron, drejton, mbikëqyr dhe shkarkon punonjësit e gjykatës; d) mbikëqyr mirëmbajtjen e godinës së gjykatës. 2. Pas këshillimit me Kryetarin e Gjykatës, kancelari është përgjegjës për: a) funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për teknologjinë dhe sigurinë e informacionit dhe mbikëqyrjen e mbledhjes dhe përpunimit të saktë të të dhënave; b) dorëzimin e raporteve

periodike për gjendjen e përdorimit dhe funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve Këshillit të Lartë Gjyqësor; c) raportimin pa vonesë Këshillit të Lartë Gjyqësor mbi nevojat dhe përditësimet e nevojshme të funksionimit të sistemit të menaxhimit të çështjeve; ç) udhëzimin dhe mbikëqyrjen e punës së nëpunësve civilë gjyqësorë të gjykatës; d) i siguron Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Ministrisë së Drejtësisë qasje në të dhënat statistikore për aq sa u nevojitet këtyre institucioneve në ushtrimin e kompetencave të tyre të caktuara me ligj; dh) kryen çdo detyrë, siç përcaktohet me ligj ose siç autorizohet nga kryetari.

Gjithashtu, në pikën 2 të nenit 25 të ligjit nr.98/2016, i ndryshuar, është parashikuar se: "2. Kancelari i gjykatës mbikëqyr procesin e organizimit dhe të dokumentimit të ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit, si dhe nënshkruan përcjelljen e praktikës së çështjes gjyqësore te gjyqtari i caktuar".

Urdhrat e njëpasnjëshëm të nxjerrë nga zëvendëskryetari i gjykatës, me të cilat pengonte znj. {...} të ushtronte detyrat e kancelares, duke e caktuar sekretare gjyqësore pranë vetes ose pranë gjyqtarit {...} dhe më pas duke e ricaktuar përsëri kancelarë, por pa revokuar urdhrin që caktonte si nëpunësin më të lartë administrativ kryesekretaren znj. {...}, krijonin konfuzion tek punonjësit e gjykatës dhe situata e krijuar mes kancelares dhe zëvendëskryetarit ishte e sikletshme për punonjësit e administratës pasi ishin nën presion.

Zëvendëskryetari është përpjekur duke nxjerrë urdhra të njëpasnjëshëm që të organizojë punën e gjykatës dhe të sigurojë mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin saj duke ngarkuar me më shumë detyra kryeskretaren, por funksionet e kancelarit që është figura përgjegjëse për menaxhimin e administrimit gjyqësor nuk ushtroheshin plotësisht nga asnjë person në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke sjellë kjo për pasojë edhe mospërmbushjen e detyrimeve ligjore të kancelares, ku ndër të tjera, mbikëqyrjen e procesit të organizimit dhe të dokumentimit të ndarjes së çështjeve gjyqësore nëpërmjet shortit, si dhe nënshkrimin e përcjelljes së praktikës së çështjes gjyqësore te gjyqtari i caktuar.

Gjithashtu veprimet e zëvendëskryetarit në shkelje të dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatës kanë sjellë pasoja në cenimin e figurës së zëvendëskryetarit.

Në analizë të kriterit "masa e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore" në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor rezulton se sjellja e papërshtatshme e

zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, subjekt hetimi disiplinor ka cenuar imazhin e zëvendëskryetarit i cili nuk ka përmbushur detyrat e tij dhe ka përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor duke siguruar mbarëvajtjen dhe funksionimin e gjykatës si institucion.

Për sa më sipër, duke mbajtur në konsideratë: (i) natyrën e shkeljeve disiplinore që referon në moszbatimin pa shkaqe të justifikuara të vendimit e dhënë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si dhe në 2 mbledhje të njëpasnjëshme të Këshillit të Gjykatës, pra në mënyrë të përsëritur, nuk ka respektuar dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave, (ii) kryerjen e shkeljes disiplinore nga ana e zëvendëskryetarit me dashje direkte; (iii) ekzistenca e rrethanës lehtësuese, e lidhur me shkeljet për herë të parë; me bashkëpunimin e magjistratit gjatë hetimit; si dhe ndihma në mënyrë aktive për të zhdukur ose pakësuar pasojat e shkeljes (iv) përvojën pothuajse 1-vjeçare në funksionin e zëvendëskryetarit; (v) mospërmbushje të detyrës së zëvendëskryetarit i cili ka përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor duke siguruar mbarëvajtjen dhe funksionimin e gjykatës si institucion, (vii) mungesën e ndonjë arsye specifike që është jashtë kontrollit të zëvendëskryetarit dhe që mund të lidhet me mosfunksionimin e sistemit gjyqësor, arrihet në konkluzionin që veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, z. {...}, që përbëjnë shkelje disiplinore parashikuar nga neni 102 pika 1, shkronjat "g" dhe "gj" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; në rastin konkret përbëjnë "Shkelje e lehtë disiplinore".

Në mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 106 dhe nenit 107, të ligjit nr. 96/2016, për shkelje të lehta disiplinore mund të jepet masa disiplinore "vërejtje konfidenciale" ose "vërejtje publike".

Vërejtja publike përmbush dy qëllime parandaluese: (i) parandalimin e posaçëm, në kuptimin që magjistrati në të ardhmen të mos kryejë më shkelje disiplinore; dhe (ii) parandalimin e përgjithshëm, në kuptimin që magjistratët e tjerë kuptojnë që një sjellje e papërshtatshme nuk duhet kryer, pasi është e ndëshkueshme me masë disiplinore.

Nga hetimi i kryer rezulton se magjistrati {...} subjekt hetimi disiplinor, me sjelljen e tij, pa shkaqe të arsyeshme, ka lejuar moszbatimin e vendimit të KLGJ-së nr. 307, datë 13.07.2021 "Për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së znj. {...} në pozicionin e kancelares së Gjykatës

Administrative të Shkallës së Parë Vlorë", si dhe në 2 mbledhje të njëpasnjëshme të Këshillit të Gjykatës, në mënyrë të përsëritur, nuk ka respektuar dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Gjykatës.

Sjellja e magjistratit z. {...}, përbën mospërmbushje të detyrës duke cenuar edhe figurën e një kryetari gjykate i cili para së gjithash për shkak të faktit se është drejtuesi i gjykatës duhet të garantojë zbatimin e vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor që gjithsesi i janë dhënë si e drejtë dhe kompetencë pikërisht nga ai ligj të cilin ai si magjistrat nuk e zbaton tërësisht.

Kjo sjellje e magjistratit {...}, në kundërshtim me ligjin e aktet nënligjore të nxjerrë në bazë e në zbatim të tij, pikërisht për të normuar funksionimin e gjykatës, përbën mospërmbushje të detyrës së kryetarit të gjykatës i cili është ai që përfaqëson institucionin në marrëdhënie me të tretët, dhe që i duhet të zbatojë fillimisht vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor për garantuar më pas, ai në cilësinë e drejtuesit të gjykatës, zbatimin e tyre. Moszbatimi pa shkaqe të arsyeshme nga ana e tij si drejtues, i një vendimi të dhënë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, vlerësohet si një sjellje joprofesionale e cila diskrediton pozitën e drejtuesit të një gjykate dhe figurën e gjyqtarit në veçanti.

Në nenin 4, pika 1, dhe 2, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, është parashikuar se magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, për të mbrojtur dhe forcuar dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij, reputacionin e organeve të drejtësisë.

Në raport me faktet e provuara në këtë proces hetimi disiplinor rezulton se sjellja e magjistratit {...} subjekt hetimi disiplinor, mund të passjell përhapjen e kësaj sjellje e cila në vetvete cenon dinjitetin dhe reputacionin e pozicionit të drejtuesit të Gjykatës. Fakti se kjo sjellje është kryer nga ana drejtuesit të gjykatës ekziston rreziku që të ndiqet edhe nga magjistratë të tjerë të të njëjtës gjykatë, çfarë nënkupton dhe rëndësinë thelbësore që ka sjellja e drejtuesit.

Duke mbajtur në konsideratë faktin se masa disiplinore është e varur nga ekzistenca e përgjegjësisë disiplinore të magjistratit, në përputhje me parimin e drejtësisë, objektivitetit, individualizimit të masës disiplinore dhe proporcionalitetit, në vlerësim të: (i) të gjitha fakteve të konstatuara dhe analizës ligjore të tyre; (ii) llojin dhe rrethanat e çështjes; (iii) formën dhe shkallën e fajësisë nëpërmjet kryerjes së shkeljes disiplinore me dashje direkte; (iv) kryerjen e shkeljes disiplinore për herë të parë; (v) vjetërsisë së magjistratit në sistemin e drejtësisë dhe të

dhënat mbi aftësitë profesionale të tij; (vi) bashkëpunimit në nivel shumë të mirë bashkëpunues të magjistratit gjatë hetimit disiplinor; (vii) ekzistencës së rrethanës lehtësuese të parashikuara në nenin 115, pika 2, shkronjat "a", "ç" dhe "d", të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; (ix) rrethanat e shkeljes përbëjnë shkelje të lehtë disiplinore dhe si e tillë nuk është e përshtatshme një masë disiplinore e rëndë; propozohet caktimi ndaj magjistratit {...} me detyrë zëvendëskryetar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, masa disiplinore "Vërejtje publike" parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja "b", dhe neni 107 i ligjit nr. 96.2016, i ndryshuar.

Për sa më sipër, kërkojmë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor të administrojë provat e paraqitura nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në këtë procedim disiplinor dhe në mbështetje të nenit 105, pika 1, shkronja "b" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të vendosë:

Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit ndaj magjistratit {...} me detyrë zëvendëskryetar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, për shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronjat "g" dhe "gj" të ligjit nr. 96/2016, dhe caktimin e masës disiplinore "Vërejtje publike".

Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zonja {...}!

Përveç provave të paraqitura deri më tani, keni prova të tjera për të paraqitur?

{...}: Jo, nuk kemi prova të tjera.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Për më tej fjala për magjistratin zotin {...}.

{...}: I nderuar Nënkryetar i KLGJ-së!

Të nderuar anëtarë të KLGJ-së!

Unë ju kam dërguar në datën 20 ose në datën 19, nuk e mbaj mend mirë, me anë të e-mailit. Gjithsesi, kam 17 faqe prapësime, unë në ndryshim nga zonja {...} nuk kam për t'i lexuar

të gjitha. Thjesht do doja pak vëmendjen tuaj, nëse është e mundur, për të thënë të gjitha në mënyrë të shkurtuar. Unë i kam ndarë prapësimet e mia në katër pjesë, ku pjesa e parë, edhe i mëshoj fort, është tendencioziteti edhe tërësisht roli paragjykues i ILD-së në këtë proces disiplinor; rasti i dytë ka të bëjë me, pika e dytë ka të bëjë me shkeljet procedurale, sikundër është afati. Nuk ka reshtur së ardhuri ILD-ja, dhe {...} është prezent vetë, me shkresa nga më të ndryshmet. Jam ndier në një presion të jashtëzakonshëm, por do vijmë pak më vonë; pika e tretë pastaj ka të bëjë me meritën e lidhjes në moszbatimin të vendimit (nuk mund të them të shkarkimit) por të përfundimit të marrëdhënies së punës me ish-kancelaren e gjykatës; dhe pika e katërt ka të bëjë me mosformimin drejt të Këshillit të Gjykatës për një periudhë tremujore, kur Këshilli i Gjykatës për një periudhë nga 2017 që kam qenë unë deri, jam zgjedhur në korrik, është mbledhur gjithsej katër apo pesë herë. Ndërsa zotërinjve u bën përshtypje pse s'është mbledhur për tre muaj (nga shtatori deri në dhjetor).

Gjithsesi unë po i hyj pikës së parë pse janë të paravendosur zotërinjtë dhe pse është tërësisht proces tendencioz. Unë nuk e di në qoftë se ka edhe ndonjë gazetar këtu se dua sinqerisht që kjo të bëhet edhe publike.

Pikësëpari që nga marsi i vitit 2021, juve ndoshta keni qenë dëshmitarë që unë kam qenë pothuajse në "prime time" në televizionin kombëtar më të madh "Top Channel", ditë për ditë në lajmet kryesore, për rreth një muaj, ku jepja vendime të padrejta, isha i paaftë, ku e di unë se çfarë, vetëm pesë ditë apo katër ditë më vonë se kisha dhënë vendimin kundër ish-drejtorit të përgjithshëm të këtij televizioni, z. {...}. Që prej asaj date zotërinjtë e ILD-së, po them në mars të 2021-it (unë jam shkarkuar në qershor nga KPK-ja), kanë kryer të paktën tre vizita në dijeninë time; kanë thirrur pesë ftesa anëtarët administrativë, domethënë kryesekretaren, sekretare, këshilltarë, IT, në ambientet e ILD-së, dhe kanë dërguar dhjetë deri në pesëmbëdhjetë ftesa (them unë afërsisht, mund të jenë edhe më shumë) për shkaqe tërësisht domethënë të njëjta, se unë mbaj mend që më vinte edhe kancelarja vetë, vinte kryesekretarja më vonë, që "ore çfarë t'i bëjmë, i kemi kthyer një herë përgjigje", domethënë thjesht për atë trysninë që ti je nën hetim.

Unë kujtoj se ILD-ja ka konstatuar si shkelje afatin 30-ditor, pra është një vendim i KLGJ-së, vendimi juaj, që thotë që mbledhjet e Këshillit të Gjykatës duhet të mblidhet për 30 ditë dhe ashtu siç kundër e thashë edhe pak më përpara, kur ka qenë më përpara kryetar z. {...} Shema apo zonja {...} apo edhe zoti {...}, në tërësi, juve mund ta shikoni në internet se janë të

publikuara procesverbalet, është mbledhur ose katër ose pesë herë. Domethënë, për tre muaj pse s'e kam mbledhur çdo 30 ditë, vijnë këtu ILD-ja dhe thotë masë disiplinore ndaj meje. Domethënë janë të qarta faktet.

Nga ana tjetër, unë meqë jam në pikën e dytë, unë po ju jap një shpallje vendimi... (e ndërpret mendimin)... pra ishte mbledh Këshilli i Gjykatës, pika e dytë, pse është e paravendosur, për t'ju treguar me pak fakte, pa i hyrë kush qëndron prapa këtij sulmi, e me radhë e me radhë, por thjesht për të treguar fakte.

Në datën 19.07. ka qenë nënkryetar zoti {...} dhe ishte edhe kancelarja zonja {...}, normalisht duhet të isha unë anëtari i Këshillit (i treti) sepse aty ishin dy gjyqtarë dhe një kancelare në Gjykatën Administrative të Vlorës. Këshilli i Gjykatës ka thirrur zonjën {...} (e keni këtu, jua kam dërguar edhe si provë, por thjesht për ta treguar), pra ka filluar procedimi për punësimin e një sekretareje të re gjyqësore (në datën 19.07., jua kam sjellë edhe si provë), ku normalisht duhet të isha unë, ç'lidhje kishte zonja {...} (shumë e nderuar në punën e saj)?! Jua kam vendosur në dijeni zotërinj "vendim arkivimi", që ligji për statusin e gjyqtarëve, kur të bën kryetari apo nënkryetari, ILD-ja ka detyrë për të vijuar procedurën, "vendim arkivimi".

Pika e tretë: Përsëri në mbledhjen e Këshillit të Gjykatës, që zotërinjtë më thonë që unë nuk e kam mbledhur mirë, është një vendim gjyqësor i formës së prerë (e ka dhënë gjyqtar {...}. Ka qenë zonja {...} (ekonomiste pranë gjykatës sonë), kishte marrë masë disiplinore (ishte propozuar nga KLGJ-ja kam përshtypjen për të marrë një masë disiplinore për shkak se nuk kishte formuar drejt tenderat e me radhë); është marrë masë disiplinore nga Këshilli i Gjykatës, ku ishte zoti {...}, zonja {...} dhe zonja kancelarë. Ky vendim i formës së prerë, në faqen 11 dhe 12 të tij thotë shprehimisht "nuk është formuar drejt Këshilli i Gjykatës pasi nuk është thirrur gjyqtari {...}; ç'punë thotë ka zonja {...} anëtare e Këshillit të Gjykatës?" Është vendimi, ia kam vendosur përsëri në dispozicion ILD-së. Asnjë lloj veprimi. Domethënë 451/a i Kodit të Procedurës Civile, ky vendim ka fuqi detyruese për të gjithë, sidomos për organet inspektuese të fillonin procedurën disiplinore ore kush janë këta përgjegjës që heqin gjyqtarin dhe vendosin një gjyqtar tjetër.

Unë po ju them edhe një rast tjetër që i doli zonjës {...} tek Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, për të treguar në fakt edhe tendenciozitetin e zotërinjve. Në Gjykatën Administrative të Vlorës ka qenë një ___ (nuk kuptohet fjala) e jashtëzakonshme blerja e shortit

elektronik të gjyqtarëve. Domethënë “urdhëro lekët” (se po e flas hapur), “jepja këtij gjyqtari”; “merr këto, çoji atij”.

Kam bërë një kërkesë për çështjen “{...}.”, e kam dërguar edhe ILD-së, kam bërë edhe kallëzim penal. IT-ja e gjykatës është dënuar me vendim gjyqësor (jo të formës së prerë, tani prej çështjen në apel), i kam vendosur të njëjtën zotërinjve “vendim arkivimi”, pra domethënë ka përgjegjësi penale por s’ka përgjegjësi disiplinore. Domethënë nuk di nga ta fillosh paragjykimin e zotërinjve.

Kështu që, pa dashur edhe më shumë të zgjatem në lidhje me kur janë rastet e diskriminimit në detyrë, sikundër propozojnë në rastin konkret, kur duhet të jetë rastet që janë edhe në GJEDNJ që unë i kam zbatuar tek vendimet e mia por unë nuk kam dashur t’i parashtroj tek ju pasi nuk doja ta bëja të lodhshme argumentet e mia, them që ky procedim i ILD-së duhet të rrëzohet dhe të konsiderohet si paragjykues dhe tendencioz.

Në lidhje me shkeljet procedurale, ligji 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve”, në nenin 118, paragrafi i parë, paragrafi i dytë dhe paragrafi i tretë përcakton disa afate (për ta kuptuar që kam qenë gjatë gjithë kohës nën presionin e zotërinjve), pasi ai parashikon dy afate, afati i parë është tre muaj, nga momenti që të vjen ankimi ILD-ja ka një lloj diskrecioni për të vepruar apo për të mos vepruar. Afati i dytë është afati 6-mujor, që zotërinjtë e kanë zbatuar në rastin konkret. Afti gjashtëmujor, që në qoftë se kërkon më shumë kohë, zbatohet KPA-ja, zgjatet një herë afati deri në 3 muaj, dhe vijon normalisht.

Vijmë tek afati i parë. Afati i parë, e thotë vetë te raporti përfundimtar zonja {...} apo ILD-ja që është regjistruar në datën 10.09.2021, pra kërkesa e kancelares, pra ankimi i kancelares. Në datën 16.09. zotërinjtë kanë ardhur (të dy, zonja {...} dhe zotëria që është këtu) kanë ardhur në zyrën time. Gjithë ditën kam anuluar gjyqet. “Jo e ke filluar, jo s’e ke filluar; pse nuk zbaton vendimi”. Ndërsa procedimi disiplinor ka filluar në datën 24.12.2021. Pra dukshëm jashtë afatit 3-mujor. Nuk dua t’jua them pse ka filluar me 24 sepse lidhet edhe me një çështje konkrete timen, që unë nuk jam mashtruar (apo *nënshtruar - nuk është e qartë fjala e gjyqtarit pasi e shpreh shumë shpejt),* dhe kanë thënë datën 24. Por ajo që dua të them është që kam qenë gjithmonë nën presion sepse ata po të kishin mundësi se nuk mund të justifikohesh që kemi shumë ngarkesë sepse verifikimin në gjykatë e bënë menjëherë, kanë ardhur në gjykatë që në datën 16, në datën 10 është regjistruar ankimi, në 16 kanë ardh dhe i kam bërë edhe e-mail se më

ka thënë zonja {...} bëj një e-mail sqarues, dhe ishin gjatë gjithë kohës që mund të fillonin procedimin disiplinor. E kanë filluar në datën 24, pasi në datën 20 (a pak më përpara) unë nuk i jam nënshtruar, por pa dashur të flas më shumë, disa presioneve për një çështje konkrete gjyqësore, dhe menjëherë mbasi s'kam bërë këtë, ka filluar ky procedim. Afati 3-mujor është i shkelur në rastin konkret dhe nuk mund të justifikohet ILD-ja që s'ka pasur kohë e me radhë, e me radhë, pasi ka pasur kohë, është paraqitur; ka ardhur në zyrën time; kemi qëndruar një ditë të tërë; kam anuluar të gjitha gjyqet; i kam bërë shkresë sqaruese, dhe e kanë regjistruar fillimin pas 3 muajsh, kur afati e thotë shprehimisht 3 muaj.

Tani në lidhje me mbledhjen e Këshillit, është konstatuar si shkelje mosmbledhja e Këshillit në shtator të 2021-it dhe janar të 2022-it (pra rreth katër muaj). Unë s'di nga t'ia filloj këtu sepse ka qenë një lëmsh i vërtetë.

Të nderuar anëtarë të KLGJ-së, unë jam zgjedh nënkryetar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë në datën 30 korrik të 2021-it. Dhe duke qenë se aty është një... aty notohej në paligjshmëri, në të gjitha kuptimet: nga mosdijenia, nga shkaqe të tjera, nga mosshkollimi i duhur, ku e di unë se çfarë. Unë jam zgjedh nënkryetar i gjykatës (e keni në mbledhje, e keni online) nga Këshilli i Gjykatës, kur unë duhet të zgjidhesha nga mbledhja e përgjithshme e gjyqtarëve. Domethënë unë kur jam zgjedhur zëvendëskryetar ka votuar kancelarja, që është e palogjikshme fare, ka qenë zoti {...}, përfaqësues i KLGJ-së, kam qenë unë, ka qenë zoti {...}, ka qenë edhe kancelarja. Domethënë unë kam qenë prezent, pra praktikisht unë nuk jam nënkryetar i gjykatës sepse jam zgjedhur nga një organ që s'duhet të ishte organ që të zgjidhte. Mbledhja është online. Çdo gjë mund të verifikohet shumë shpejt.

Pasi jam zgjedh me 31, sepse unë vija gjyqtar me çështjet e mia, s'kisha asnjë lloj eksperience në mbledhjen e gjykatës, i mora të mirëqenë atë që më kishte thënë kancelarja sepse është edhe një vendim i juaji që thotë që mbledhjen, të gjitha shkresat, projektvendimet i regjistron apo i bën kancelarja, thjesht ne vemi tre ditë përpara njoftohemi për këto akte dhe i diskutojmë në Këshill. Unë e mora të mirëqenë.. pra unë jam zgjedhur nënkryetar gjykate nga mbledhja e Këshillit të Gjykatës dhe përsëri ILD-së nuk i bën përshtypje ky fakt.

Më pas ne kemi pas një problematikë të tillë. Unë isha nënkryetar i gjykatës. Është një vendim i juaji që thotë që nuk mund të mblidhet Këshilli i Gjykatës me tre anëtarë, me dy anëtarë, më falni, duhet të mblidhet se s'bën me tre anëtarë. Në rregull. Dhe thotë që gjyqtari

thërret anëtarin e tretë (pra isha unë, ishte kancelari dhe unë si nënkryetar duhet të thirrja anëtarin e tretë me stazh profesional më të vjetër, e thotë vendimi i KLGJ-së i 2019-ës në mos gaboj). Tani unë u vendosa përpara një dileme të tillë sepse unë në gjykatë kisha dy gjyqtarë të tjerë që kishin mbaruar shkollën bashkë tek Shkolla e Magjistraturës, kishin bërë të njëjtin stazh profesional, ishte zoti {...} dhe zonja {...}. Pra kishin të njëjtin stad profesional. I kam bërë shkresë KLGJ-së, meqë ishte organ kompetent emërues, i them cili është, domethënë të lutem më ndihmoni, më jepni një lloj shtyse sepse unë lajmëroj, unë nuk caktoj (e thotë vendimi, e kam cituar edhe tek prapësimet çfarë thotë vendimi i KLGJ-së, unë lajmëroj personin që ka më shumë stazh profesional). Në rastin konkret unë kë të lajmëroja? I them kancelares eja të bisedojmë, se gjykimi me tre anëtarë nuk do të thotë që gjykimi me dy anëtarë nuk mund të bëhet fare, domethënë zërohet. Domethënë ne mund të mblidhemi (këtë e kam bindje) por që nuk mund të marrim vendime meritorike. Është pak a shumë, kush është gjyqtar më kupton shumë mirë, që kur kemi me tre gjyqtarë, mungon një gjyqtar, ne e bëjmë seancën dhe themi që nuk bëhet kjo seancë për këtë arsye, duke vendosur datën tjetër. Dhe unë këtë kam kërkuar kancelares, dhe i them "pavarësisht se jemi tre anëtarë, jemi dy, të lutem hajde çfarë të diskutojmë kush do jetë anëtari i tretë sepse si gjyqtar {...}, si gjyqtare{...}kanë të njëjtin stazh profesional". E bëj vetë shkresën për KLGJ-në. Asnjë lloj përgjigje. Në këto rrethana, pra nuk është se unë kam qenë, i kam bërë kashirllëk. Kemi qenë tre anëtarë aty, nuk i mora të tretin anëtar. Këtu po, do ishte përgjegjësi disiplinore. Në momentin që kanë qenë të dy anëtarët në të njëjtin stazh profesional, unë duhet të zgjidhja një të tretë... kjo është arsyeja përse nuk është mbledhur dy apo tre herë, dy ose tre muaj, më falni, Këshilli i Gjykatës. Por edhe për një moment (sepse unë jam marrë pak edhe me praktikën ndërkombëtare por edhe praktikën ndërkombëtare të funksionimit të organeve kolegjiale), edhe nëse unë do kisha zgjedhur për shembull gjyqtar {...} të parin, përsëri ne duhet ta bënim mbledhjen me dy anëtarë. E kam konceptin... thjesht të lutem më kuptoni. Sepse mbledhja me dy anëtarë, siç është, ju jeni vetë organ kolegjial, kur vjen një anëtar i tretë, ju që jeni prezent më të vjetër shikoni kriteret e emërimit si është zgjedhur e me radhë e me radhë; apo edhe deputetin e ri në Parlament, shikohet mënyra e emërimit, mënyra e zgjedhjes, është zgjedhur siç duhet, ka ardhur raporti nga KQZ, e me radhë, në këtë moment ftohet dhe betohet deputeti i ri. Të njëjtën gjë edhe në qoftë se unë do të kisha mënyrë tjetër për ta zgjedhur anëtarin e tretë (jo që s'kisha mundësi, ishin në të njëjtin stazh profesional) prapë do të mblidheshim me

dy veta. Pra të thoshim tani “ore është zgjedhur mirë ky anëtari i tretë; kam vepruar unë mirë”, prapë pa marrë vendime meritorike, pra vendime thelbësore për çështjen.

Unë përsëri i referohem këtu, procedurën që do fillonim ne që unë jam gjetur në shkelje nga ILD-ja është një procedurë për lëvizje paralele dhe pranimin në shërbim civil. Se duhet ta fillojmë nga A-ja. Unë prandaj them jam tendenciozë zotërinjtë. Ky vendim, po them edhe një herë, ka filluar më datë 19.07., ka qenë Këshilli ku unë duhet të isha, nuk isha (nuk jam thirrur fare, është thirrur zonja {...}). Nuk është formuar drejt Këshilli. Këtë as e merr fare parasysh zonja, por merr parasysh hapat e mëvonshëm që janë marrë, “jo pse s’ke thirrur {...}, jo pse s’ke thirrur gjyqtare {...}”. Këtë që unë gjyqtar duhet të isha anëtar Këshilli apo jo... se unë nuk kam bërë asnjë vendim, asnjë mbledhje Këshilli. Këtu është mbledhur Këshilli në mënyrë flagrante duke shkelur ligjin. Unë s’kam mbledhur, kam shtyrë, i kam ftuar ata hajde çfarë të bëjmë, pra për ta zgjidhur çështjen me mirëkuptim.

Unë do të doja t’ju ftoja edhe një herë, ore se kështu siç e parashtron zonja (se nuk dua të zgjatem shumë)... Ore ka ndonjë problem? Përse s’e kam thirrur unë Këshillin? Domethënë bëjini një pyetje vetë. Pse s’e ka bërë ky Këshillin? Pse s’e ka thirru ky Këshillin kur i ka pasur të gjitha mundësitë? Domethënë është një logjikë... bën të jem i marrë fare dhe kam ikur nga realiteti. Ku e di unë se çfarë?!

Ajo që unë këmbëngul fort është parimi që unë nuk kam pasur, nuk kam qenë në kushtet normale për të funksionuar gjykata. Afati është vetëm tre muaj shkelje. Në qoftë se kam qenë... se unë nuk e kam e zbatuar vendimin e shkarkimit të kancelares dhe ajo nuk është paraqitur, pra kam qenë unë pengesa, ajo është kthyer për një muaj ose dy muaj më mbrapa, është thirrur dhe ajo ikte, nuk vinte në mbledhje të Këshillit. Pra duhet ta kuptoni këtë që unë kam bërë... okej në rregull, për një muaj nuk ka zbatuar vendimin, nuk e kam njohur kancelaren si kancelare. Por pastaj kur e kam njohur pse nuk vinte të fliste në mbledhjen e Këshillit? Pra janë shumë gjëra që po të mblidhen bashkë kuptohet që unë do të kisha përgjegjësi disiplinore në qoftë se unë do t’i kisha bërë kashirllëk Mbledhjes së Këshillit, se unë i kisha të gjitha kushtet. Por në momentin që unë nuk kam asnjë lloj kushti, mendoj se nuk kemi masë disiplinore.

Ndërsa për moszbatimin e vendimit të mbarimit të statusit unë po ju jap vetëm dy arsye. Ky inicim ka pasur një kontakt që unë kam pasur me një anëtar të KLGJ-së, që unë nuk dua t’i përmend emrin, por jua kam sjellë si provë, ku po ta shikoni është bërë në datën përpara se të

isha nënkryetar gjykate, është bërë diku rreth 15-16 korrikut apo 20 korrikut, dhe më ka thënë shprehimisht që duhet të shkarkosh, duhet të mos pranosh kancelaren sepse është shkarkuar me vendim të KLGJ-së. Nga ana tjetër unë përsëri kam bërë shkresë KLGJ-së dhe i kam thënë, të lutem më sqaro dhe interpreto vendimin (e kam bërë dhe e kam dërguar me e-mail, i keni këtu të gjitha), dhe në fund i kam thënë unë kështu do ta zbatoj se kështu është botëkuptimi im për ligjin. Në qoftë se ju, ju lutem anëtarë të KLGJ-së (e kam dërguar edhe me shkresë të posaçme por edhe me e-mail), në qoftë se juve mendoni ndryshe, ju lutem më njoftoni. Këtë e kam bërë për dy arsye sepse zonja kancelare, në ambientet e punës, përmendte dy emra të anëtarëve të KLGJ-së: "që më kanë thënë kështu, zbatohet kështu, janë miqtë e mi", - e me radhë. Ndërsa një anëtar tjetër, sikundër keni provën, thoshte që jo, do ta zbatosh menjëherë. Tani, unë jam vendosur përpara dy fakteve: njëri anëtar thoshte po, tjetri thoshte jo. Dhe për të qenë korrekt me të gjithë procedurën ju kam bërë një shkresë për sqarim dhe interpretim vendimi. Nuk kam marrë asnjë lloj shkrese (përgjigje) nga ana juaj dhe në këto rrethana e kam... më ka ardhur një shkresë nga një trupë administrative por gjithsesi duke ditur thelbin, sqarimin dhe interpretimin e vendimit (gjyqtarët e dinë shumë mirë) që bëhet nga gjyqtari që e ka dhënë, nuk mund ta bëjë sekretarja apo kancelari dhe unë kam kërkuar që këtë interpretim dhe sqarim vendimi të bëhej nga organi kolegjial i KLGJ-së.

Unë kaq kisha. Thashë pikat më kryesore. Jam i hapur për çdo lloj pyetjeje apo çdo lloj debati që mund të kem me ILD-në.

Ilir Rusi: Faleminderit, zoti {...}!

Përveç provave të paraqitura deri më tani, keni prova të tjera?

{...}: Nuk kam asnjë provë tjetër.

Ilir Rusi: Faleminderit!

Ftoj anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor nëse kanë diçka për të thënë, për të pyetur.

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Faleminderit, z. Zëvendëskryetar!

Unë kam një pyetje për zotin {...}.

Në fjalën tuaj cituat që jeni zgjedhur si zëvendëskryetar nga Këshilli i Gjykatës dhe jo nga mbledhja e gjyqtarëve. Pse keni pranuar të kryeni funksione ndërkohë që nuk jeni zgjedhur sipas ligjit?

{...}: Këtë problematikë e kam ngritur edhe kur kanë ardhur një grup inspektuesish nga KLGJ-ja, z. {...}, znj. {...}, dhe një anëtar i tretë që i di vetëm emrin shkurt, por nuk ia di emrin e gjatë, dhe arritëm në përfundimin që për të mirë të organizimit të gjykatës, ajo mbledhje e Këshillit, që është mbledh Këshilli (është hapur e Këshillit), ishte mbledhje e përgjithshme e gjyqtarëve, e ka thënë zoti {...} (vetë përfaqësuesi i KLGJ-së, kemi qenë tek zyra ime). Sepse pastaj i bie që të bëheshin nul të gjitha vendimet e mëparshme, futej gjykata në një ngërç të jashtëzakonshëm dhe për të mirën e përbashkët, si të KLGJ-së dhe të gjykatës është vendosur kjo zonjë. E kuptoj shumë mirë që mund të jetë... por prandaj po ju them që aty ka notuar... ne kemi marrë vendime Këshilli pa u mbledh fare Këshilli. Unë po ju japë raste, për shembull ky vendim Këshilli i Gjykatës është bërë pa u mbledhur fare. Juve mund ta shikoni, është data 19.07. Ka ndonjë mbledhje Këshilli, siç thotë vendimi juaj, të pasqyruar? Pra ka notuar në paligjshmëri. Prandaj unë kam ardhur dhe kam vendosur të bëj një lloj formalizimi, që deri në atë moment nuk kishte fare. Unë ju ftoj, në datën 19.07., ka ndonjë mbledhje Këshilli në faqen zyrtare të Gjykatës Administrative të Vlorës? – Nuk ka. Kemi arritur në këtë përfundim. Kjo është përgjigjja ime.

Brikena Ukperaj: Edhe një pyetje tjetër kam.

Ju jeni zgjedhur zëvendëskryetar në fund të korrikut, 30.08.2021. Cilët kanë qenë gjyqtarët që kanë qenë në detyrë në gjykatë në atë kohë?

{...}: Kam qenë unë dhe zoti {...}.

Brikena Ukperaj: Atëherë, a e kishe Këshillin e Gjykatës të konstituuar në këtë moment? Se zonja {...}, ne sot, për fat, më konçidojnë datat sepse përsëritëm transferimin dhe më rezulton që ka ardhur në tetor në gjykatë.

{...}: Konstituimi zonja gjyqtare nuk bëhet menjëherë, duhet të mblidhet Këshilli, bëhet mbledhja e Këshillit, njoftohet tre ditë përpara, të bëhet shpallja e mungesës ato ditë ___ (nuk kuptohet fjala e gjyqtarit). Se kështu bëhet apo jo? Pra është mbledhje Këshilli. Dhe në këtë moment do themi kush është anëtari i tretë. Dhe anëtari i tretë ka qenë zoti... Po pra do mblidhet Këshilli një herë. Apo e vendos unë? Nuk bëhet automatikisht. Do mblidhet Këshilli dhe Këshilli në dijeninë time është mbledhur në nëntor ose në dhjetor.

Brikena Ukperaj: Ju ishit zëvendëskryetari i Këshillit dhe për fat unë kam qenë në atë grup pune që kemi bërë edhe atë rregulloren e funksionimit të këshillave të gjykatës, dhe e di si funksionon me anëtarin zëvendësues. Zëvendëskryetari në detyrë (që jeni ju), dakord nuk e mblodhët në gusht se është çështja e pushimeve. E ka së paku 1 herë në muaj (nuk e ka mblidhet detyrimisht), "së paku" thotë rregullorja. Nuk e mblodhët.

Në shtator e kishit Këshillin e konstituuar. Këshilli nuk ndryshon sa herë ndryshojnë gjyqtarët në atë gjykatë dhe nuk ka nevojë {...} që Këshilli të verifikojë si është zgjedhur anëtari i tretë apo të verifikojë si iku ai anëtari. Mblidhet Këshilli, ka një rend dite. Zëvendëskryetari e thërret mbledhjen e Këshillit sipas rendit të ditës dhe diskutohet. Domethënë nuk ka nevojë për të gjithë këto procedura. Ju jeni organ administrimi në gjykatë, me kompetenca të përcaktuara. Domethënë gjithë kjo mungesë derisa ka ardhur zonja {...}, ka ardhur në fund të tetorit, domethënë në fund të tetorit është transferuar tek ju. Kështu që deri në fund të tetorit kishin e kishit të konstituuar. Kjo ishte e gjithë pyetja ime. Domethënë, pse? Për çfarë arsye?

{...}: Po pra, ne këtu ndahemi sepse unë them që nuk bëhet konstituimi i menjëhershëm i Këshillit. Këshilli nuk bëhet automatikisht, se iku njëri, vjen tjetri. Duhet të mblidhet Këshilli ekzistues me dy anëtarë, të thotë që ky anëtar është larguar dhe të përzgjidhet anëtari i tretë. Ky është i gjithë diskutimi. Nga ana tjetër, jo më larg se 30 korrik aty thuhej që (15 korrik), zoti anëtar i KLGJ-së më thoshte që anëtarja është shkarkuar automatikisht nga detyra.

Po pra kjo është, se nuk formoheshe, se nuk ishte kancelarja pastaj.

Po pra, po çfarë thotë vendimi zonja Ukperaj?

Brikena Ukperaj: Nuk do të shpjegoj se çfarë thotë vendimi por referojmë në shkeljet disiplinore që ju janë atribuuar ose në fakte që përbëjnë shkelje disiplinore sipas pretendimit të ILD-së. Gjithë dilema ime ishte që një Këshill Gjykate që ka qenë i konstituuar dhe nuk zgjidhet anëtari, quhet me rregullore dhe me ligj, konsiderohet i zgjedhur si anëtar automatikisht në Këshillin e Gjykatës. Në qoftë se ne do të vazhdonim kështu i bie që të thërrisnim, të zëvendësonim, dhe asnjëherë s'do mblidhej Këshilli i Gjykatës. Po kur të kishte një nevojë buxhetore, si do t'ia bënit ju? Më kupton? Domethënë Këshilli është një organ që.. prandaj edhe parashikohen gjithmonë zëvendësuesit, prandaj edhe parashikohet që gjithmonë do të jenë tre veta që të bëhet Këshilli i Gjykatës, që të jetë një organ operativ, të ketë vendimmarrje, se ka një pushtet shumë të madh administrimi në gjykatë. Ti mund të kesh qenë në dil{...} mbasi{...}ka ardhur, se kush do të ishte. Por ti Këshillin e kishe të konstituuar. Ky ishte i gjithë diskutimi që të thashë.

{...}: Unë prapë ndaj qëndrimin totalisht kundër, që Këshilli nuk konstituohet automatikisht. Është parimi i kontinuitetit dhe parimi i pavarësisë së Këshillit. Në qoftë se pastaj vijmë, unë thërras anëtarin e tretë pa qenë Këshilli vetë, Këshilli duhet të mblidhet, të konstatojë që mungon një anëtar, dhe të diskutojë cili është anëtari i tretë. Dy anëtarët që mbeten, të thonë kjo është detyra ime si nënkryetar gjykate, të thërrasë anëtarin e tretë të Këshillit. Pra është procedura zonjë. Procedura është thelbi i gjësë. Nuk mund të bëhet automatikisht, e me radhë e me radhë, sepse automatikisht arritëm në këtë përfundim, që unë duhet të isha anëtar i gjykatës, anëtar i Këshillit dhe nuk kam qenë anëtar i Këshillit. Kjo është sepse po s'pati procedurë, është neni 108 i KPA-së, është absolutisht e pavlefshme.

Klodian Kurushi: Për të vijuar më tej.

Ilir Rusi: Po, zoti Kurushi! Fjala për ju!

Klodian Kurushi: E kuptojmë këtë pjesën e procedurës, por do doja të isha më i qartë unë personalisht. Pra ju dy anëtarë të Këshillit ishit, pra ju dhe kancelari. Ndërkohë ishte edhe një gjyqtar në detyrë. Por ju thoni që nuk vepronit dot, ta thërrasim dhe ta konstituojmë mbledhjen e

Këshillit me të tretin, por na duhet një procedurë që të bëjmë zëvendësimin, me sa kuptova unë. Jam i qartë për këtë pjesën?

Po mirë, për një muaj, pse nuk e bëtë këtë?

Pra data 30 korrik, e kuptoj, jemi në kushte që nuk bëhet, është e pamundur. Muaji gusht është muaj pushimi përgjithësisht (tre javët e muajit gusht janë pushim të njëpasnjëshme). Po e marrim edhe gushtin pushim. Jemi në muajin shtator para se sa të vijë në fund të tetorit znj. {...}. Gjatë kësaj kohe, ju keni bërë përpjekje për të mbledhur Këshillin? - duke respektuar edhe atë merak që keni ju, procedurën në këtë rast, që duhet ta zëvendësojmë anëtarin. A keni bërë ndonjë përpjekje për të zëvendësuar anëtarin e tretë? Faleminderit!

{...}: Faleminderit!

Ju duhet të dini edhe diçka, unë jam produkt i shoqërisë dhe i vendit të punës ku punoj. Po ju them edhe një herë. Këshilli i Gjykatës, që kur ka qenë zoti {...} Shema, ka vajtur në shkurt të 2017-ës, deri kur ka ikur zotëria në 2020, në qershor (pak a shumë), nuk është mbledh as edhe një herë. Nga zonja gjyqtare, znj. {...} mund të jetë mbledh dy ose tre herë (domethënë një vit që ka qenë zonja). Ndërsa tek zoti {...}, në tre ose katër mbledhje, dy janë: njëra është e certifikuar me vendim gjykate si absolutisht i pavlefshëm dhe tjetra është kjo që po ju them unë, që ka qenë zonja {...}.

Ju duhet të kuptoni që unë jam produkt i asaj marrëdhënie pune (kolektivi i punës që isha aty). Në momentin që unë po them kam qenë ... se kështu merret.. (është e paqartë fjala e gjyqtarit). Unë jam zgjedhur nga Këshilli i Gjykatës, zoti anëtar i KLGJ-së. Domethënë nuk e kisha idenë që duhet të mblidhesh Këshilli i Gjykatës apo duhet të mblidhej Mbledhja e Gjyqtarëve. E kam në kuptimin që, vetë ata që ishin më përpara as e kishin lexuar ndonjëherë ligjin. Tani, të më thoni mua pse nuk e ke mbledhur për një muaj ose për dy muaj, më duket pak e ekzagjeruar.

Po, e drejtë që duhej të mblidhej për një muaj, por unë kam qenë... ka ikur gjyqtar {...}i, ka ikur gjyqtare {...}, ka ikur edhe gjyqtar z. {...}, dhe unë në fund kam pasur 1500 çështje. Tani, që të më kërkosh mua llogari me një kancelare aspak bashkëpunuese; që pse s'e kam mbledhur një herë në muaj, kam pasur mundësi... unë them, kur e kam mbledh Këshillin në nëntor apo në dhjetor, kam qenë përpara këtij fakti. Pra dua të jap bindjen time, si e mendoj unë, pastaj unë

mund ta kem gabim. Mbledhja e Këshillit mblidhet në datën "kaq" dhe themi jam unë me zonjën kancelare. Dhe i them: -Mungon anëtari i tretë. – Përse? Sepse është shkarkuar. Atëherë konstatojmë mungesën e anëtarit të tretë. Të fillojë procedura për zëvendësimin e tij. Ky zëvendësim, kush do të jetë? Në këtë moment, kur e kam mbledhur unë në nëntor apo në dhjetor, ka qenë zonja {...} dhe zoti {...} dhe të dy donin të ishin anëtarë të KLGJ-së, të ishin anëtarë të Këshillit, më fal. Këtu ka ndodhur (është parim i kontinuitetit), nuk mund të zëvendësohet automatikisht apo mbaj mend të kem pasur diskutime me trupën administrative të KLGJ-së që ta zgjidhja unë, të mblidhja unë një grup ad hoc; propozime nga më të ndryshmet për të zgjedhur unë anëtarin e tretë të KLGJ-së (duhet të jetë lapsus nga magjistrati fjala "KLGJ-së"). Edhe këtë e kam dëgjuar, këtë që thoni ju, që është automatikisht, por unë vlerësoj që kjo nuk është e drejtë. Është parimi i kontinuitetit të organit kolegjial. Organi kolegjial duhet të mblidhet aq sa është, me një, me dy veta; mos të marri vendime meritorike pasi del kundër vendimit të KLGJ-së, por në atë moment ai duhet të marrë vendimet e duhura për të krijuar atë kontinuitetin e organit kolegjial.

Klodian Kurushi: Mirë, faleminderit!

E kuptova këtë pjesën.

Por, tani vijojmë pak më tej sepse ne jemi të detyruar për të bërë ca pyetje, për sa kohë edhe atribuimi i shkeljeve të propozuara nga ana e ILD-së është pikërisht kjo lloj veprimtarie, - apo jo? Kjo kohë, pse nuk është mbledhur Këshilli brenda afateve të përcaktuara në rregullore dhe në ligj.

Doja të bëja një pyetje dhe doja një përgjigje të sinqertë për këtë pjesë.

Juve, përpara se të zgjidheshit si zëvendëskryetar i gjykatës, dhe në momentin që u zgjodhët, a e keni pasur një shqetësim vetë që unë duhet ta organizojë mbledhjen e një Këshilli sepse ndryshe veprimtaria e gjykatës nuk do shkojë aty ku duhet? E keni pasur si shqetësim?

{...}: Patjetër që kam pasur një lloj shqetësimi. Shumë gjëra dhe i kam mësuar gjatë punës po them sepse ka notuar në paligjshmëri ajo gjykatë. Rastet jua solla. Nuk e dija që duhet të mblidhej brenda një muaji. Ne jemi përballur me sjellje nga më të jashtëzakonshmet kur erdhi edhe gjyqtare {...}. Ne nuk kishim sekretare, nuk kishim sekretare gjyqësore. Të gjitha shkonin

me leje lindje, domethënë u bë një lloj, dosjet që më vinin mua ... (është e paqartë fjala e gjyqtarit). Shqetësimin e kam pasur, por mendoj se shtyrja, mosbërja nga një muaj deri në dy muaj të mbledhjes së Këshillit ka qenë, duke marrë edhe rrethanat që kam punuar me rreth 1500 dosje, tani kam 6 muaj që jam shkarkuar nga KPK-ja, unë kam akoma vendime për të arsyetuar. Imagjino çfarë ngarkese kam.

Por unë ju ftoj përsëri të kuptoni që ky nuk është shkaku i vërtetë, por ky është sebepi. Unë nuk dua t'ju ngarkoj, as t'ju lodh për çfarë çështje konkrete bëhet fjalë. Janë disa çështje, që kemi ardhur deri këtu. Apo edhe gjëra të tjera, por gjithsesi unë po e lë me kaq.

Klodian Kurushi: Okej! Faleminderit për këtë pjesën.

Tani kuptova që në disa raste, në mënyrë të përsëritur thoni që ajo gjykatë ka (nuk po gjej fjalën e duhur), siç e cituat ju, ka notuar në paligjshmëri. A i përligjni këto vlerësime që ju i keni edhe të konstatuara ndaj ish-kolegëve tuaj, apo jo? Nuk besoj të përligjni paligjshmërinë, mosmarrjen e masave për të bërë mbledhjen. Nuk dakordësoheni me këtë, apo jo?

Okej, këtë doja të dija. Domethënë të jem i qartë unë. Paligjshmëria e tyre, siç e thoni ju, nuk mund të jetë shkak për të përligjur atë lloj veprimtarie edhe për pasuesit në të ardhmen, apo jo?

{...}: Patjetër që nuk është përligjje.

Unë po ju them, e përmend këtë paligjshmërinë për të treguar pse janë të paravendosur zotërinjtë. Se të mos mbledhësh Këshillin e Gjykatës për katër vjet, katër vjet e gjysmë, ta mbledhësh katër ose me numrat e gishtave të njërës dorë, dhe të shqetësohesh pse s'e ke mbledhur Këshillin e Gjykatës një herë në muaj, për një afat prej tre muajsh, mua më duket jo tendencioze por kjo është ulëritëse fare, e para. E dyta, unë nuk po akuzoj kurrkënd këtu. Unë po them, duke treguar shkaqet, them që ILD-ja është tendencioze. Dhe e dyta, për të treguar se ku kam qenë, se unë tani nuk mund të ndriçoja i zhytur në baltë. Unë po them jam zgjedhur nënkryetar i gjykatës nga Këshilli i Gjykatës. Më shumë se kaq unë nuk kam se çfarë të them tjetër. Domethënë ka qenë komplet.. nuk merrej vesh, i pari nuk merr vesh të dytin. Vendosja e një standardi të tillë nga ana ime për të formuar unë... Se unë kam studiuar në Shqipëri dhe më bën shumë përshtypje kjo. Është parimi i kontinuitetit të organit kolegjial. Është organ kolegjial

dhe duhet të vijojë normalisht. Ata që mbeten vazhdojnë, nuk marrin vendime meritorike por marrin... është pavarësia. Në qoftë se një organ, qoftë edhe unë nënkryetar them që do vijë ky, humbet pavarësinë organi kolegjial.

Organi kolegjial duhet të diskutojë: -"Na iku njëri. Kë do zëvendësojmë?"

"Është kompetenca jote" - do më thoshte kancelarja. "Urdhëro, zgjidhe ti."

Do i thosha unë: -"Kush nga këta të dy?"

Pra duhet diskutuar. Fakti që ju keni thënë që me tre anëtarë nuk bëhet, nuk do të thotë që në të gjitha rastet nuk bëhet. Merren vendime meritorike, patjetër, por organi kolegjial, qoftë edhe me dy veta duhet të vazhdojë sikundër (se ju jeni gjyqtarë pjesa më e madhe dhe e dini shumë mirë që kur mungon një anëtar i tretë i trupit gjykues, dy anëtarët vazhdojnë gjykimin dhe thonë "është paraqitur pala paditëse; është paraqitur pala e paditur; njoftojmë palët sepse mungon anëtari i tretë". Këtë kërkova edhe unë nga zonja tjetër kancelarë, të vinim të diskutonim. Kjo është e gjitha.

Fakti pastaj pse s'e kam mbledhur për dy muaj, për tre muaj, mua më duket në atë backlog-un, në atë background-in që ka pasur ajo gjykatë më mbrapa, prandaj po them është ulëritëse, jo tendencioze por është ulëritëse.

Unë nuk po akuzoj, se dua të theksoj, nuk po akuzoj askënd. Por duke treguar fakte njëra pas tjetrës them që zotërinjtë janë tendenciozë në këtë çështje.

Klodian Kurushi: Edhe një pyetje të fundit.

Ndërmjet të tjerave, keni paraqitur si provë edhe një lloj komunikimi elektronik që ju keni bërë me një ish-anëtar të KLGJ-së, apo jo? A mund të tregoni arsyet se çfarë kërkoni të provoni me përmbajtjen e këtyre bisedave në këtë mbledhje (në këtë çështje që është përpara KLGJ-së)?

{...}: Mirëbesimin tim. Vetëm këtë.

Mirëbesimin tim të kryeja të gjithë përpjekjet nga ana ime për të treguar... Unë atë e kam pas profesor, zotin {...}. Nuk kam asnjë lloj problemi. Një njohje komplet sipërfaqësore. Por nga të gjithë anëtarët e KLGJ-së, atë njihja pak më shumë, dhe i kam thënë: -"Të lutem më oriento. Çfarë bëhet me këtë rast konkret."

Më ka thënë që: “Duhet ta pushosh menjëherë nga puna”, - besoj se e keni lexuar.

Menjëherë kam bërë shkresë KLGJ-së për sqarim dhe interpretim vendimi.

Kjo është e gjitha. Pra për të treguar mirëbesimin dhe përpjekjet e mia përtej normales, duke qenë se unë kam pas 25-30 gjyqe në ditë. (nuk kuptohet fjala e gjyqtarit)... kancelare, nga sekretare, komplet; jo të ngarkuar plotësisht me punë. Unë kam bërë të gjitha përpjekjet e mia për ta zgjidh çështjen me mirëbesim.

Klodian Kurushi: E kuptova, por a nuk ishte e mjaftueshme vetëm kërkesa që ju i keni bërë KLGJ-së mbi mënyrën se si do të procedohej më tej pas vendimit që kishte marrë KLGJ-ja për shkarkimin nga detyra të kancelares? A nuk do të ishte e mjaftueshme kjo provë për të përligjur mirëbesimin tuaj edhe përpjekjen tuaj?

{...}: Po patjetër, patjetër!

Këto kanë nevojë për diskutim, në qoftë se kam bërë mirë, në qoftë se kam bërë keq. Ajo që dua të them është që unë duke treguar të tregojë sepse ai ka qenë, po ta shikoni, unë i them “profesor”, ka qenë shumë korrekt edhe si komunikim, por tregova që unë s’kam asnjë lloj lidhje të afërt, ku e di unë se çfarë, nxora ndonjë shok apo jo. Është “Të lutem profesor më ndihmo. Kemi këtë problematikë. Kam frikë se mos më prishen vendimet” - se unë atëherë s’kam qenë fare nënkryetar - “Kam frikë se mos më prishen vendimet e mia në apel sepse po i firmos kancelarja”. Dhe më ka thënë “Duhet shkarkuar menjëherë. {...} do ta ngre si shqetësim në KLGJ”, e me radhë. Pra e kam treguar këtë për të treguar mirëbesimin. Nuk kam asnjë lloj gjëje. Unë kam shumë respekt për të. Kam përshtypjen kemi një respekt të ndërsjellët. Kjo është e gjitha. Pra ajo që dua të them është që nuk i kam bërë kashirllëk ligjit. Këtu do të ishte, në mendimin tim, arsyeja për procedim disiplinor. Në momentin që këtu ka interpretime, jo po është kështu, jo po është ashtu, unë them që nuk ka procedim disiplinor. Në mendimin tim. Në momentin që unë kisha të gjitha kushtet për të formuar Këshillin e Gjykatës, në momentin kur të kisha të gjitha kushtet për të mos pasur këtë presion të jashtëzakonshëm nga ILD-ja, që erdhi një herë, më gjeti në shkelje, e me radhë e me radhë; këtu po, kemi përgjegjësi disiplinore. Në momentin që këtu ka diskutime, unë në parim them që nuk kemi përgjegjësi disiplinore dhe i

kthehem edhe një herë asaj që e kam bërë thjesht për të treguar mirëbesimin tim gjatë gjithë këtij procesi ku kam qenë unë kryetar gjykate.

Klodian Kurushi: Gjithsesi ishte një komunikim informal, apo jo?

(Nuk dëgjohet përgjigjja e z. {...})

Okej!

Mirë! Faleminderit!

Ilir Rusi: Faleminderit zoti Kurushi!

Nga anëtarë të tjerë ka diskutime apo pyetje?

Po, zonja Ukperaj!

Brikena Ukperaj: Një pyetje për përfaqësuesit e ILD-së.

Gjyqtari {...} sot është i shkarkuar nga procesi i rivlerësimit kalimtar, pra masa disiplinore e shkarkimit ka filluar të prodhojë efektet.

Në kuadër të këtij procedimi disiplinor ju vini me kërkesën e caktimit të një mase disiplinore "vërejtje publike", ndërkohë që gjyqtari është me një masë disiplinore më të rëndë aktualisht. Apo jo? Keni në një qëndrim institucional tuajin se cila është ecuria e hetimeve disiplinore të filluara në rastet kur gjyqtari që është subjekt i këtij hetimi disiplinor në fakt është i shkarkuar (shkarkohet). Dhe pse jua them këtë?! Në shtator jemi njoftuar me një vendim tjetër të ILD-së, vendimi është për pezullimin e hetimit disiplinor ndaj një magjistrati tjetër, për shkakun se ai ishte i shkarkuar ndërkohë, jo nga organet e rivlerësimit, por ishte i shkarkuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Por gjithsesi jemi përpara të njëjtës situatë. Pra kemi dy gjyqtarë të shkarkuar, për njërin na keni sjellë pezullimin e hetimit disiplinor dhe me atë arsyetim të qëndrimit që Këshilli ka mbajtur aktualisht deri tani, që për sa kohë është një procedurë që ka lidhje me statusin e gjyqtarit, nuk mund të vijojë hetimi disiplinor, dhe ne kemi disa qëndrime që ju i dini. Me të njëjtin arsyetim keni pezulluar këtë hetimin disiplinor, ndërkohë që jemi para të njëjtit rast, ku ju kërkoni në Këshill fillimin e hetimit disiplinor dhe propozoni një masë disiplinore më të butë se shkarkimi. Një përgjigje zonja {...}.

{...}: Qëndrimi ynë është që, procedura e ndjekur nga organet e rivlerësimit nuk mund të pezullojë (flasim për këtë rast) procedurat që ndjek Inspektori i Lartë i Drejtësisë dhe Këshilli, për sa kohë nuk flasin dhe nuk trajtojnë të njëjtat fakte. Pra në momentin që nuk trajtojnë dhe nuk flasin për të njëjtat fakte, procedurat në këndvështrimin e institucionit sipas ligjit që është i drejtpërdrejtë, procedurat duhet të vazhdojnë, pavarësisht se mund të jenë për fakte të ndryshme (janë dy procedime disiplinore por për fakte të ndryshme). Në momentin kur flasim për të njëjtat fakte dhe për të njëjtat rrethana, atëherë mund të vendoset pezullimi. Pra qëndrimi i institucionit është, në momentin që nuk flasim për të njëjtat fakte dhe rrethana, procedurat mund të vazhdojnë, pavarësisht se janë paralele për fakte të tjera.

{...}: Mund të them diçka në lidhje me këtë?

Ilir Rusi: Po, zoti {...}!

{...}: Vendimi 208... Jo, më falni. Vendimi i KPK-së 541, datë 15.06.2022 është marrë edhe me këtë, ka qenë ankuese zonja {...}. Është marrë me këtë.

{...}: A mund të shtoj?

Ilir Rusi: Po, zonja {...}!

{...}: Atëherë, vendimi nr. 541, 15.06.2022 që është vendimi i KPK-së, që i përket procesit të rivlerësimit të z. {...}, ndër të tjera, në paragrafin 10.27.26 përmend që: "Denoncuesja (i referohet znj. {...}) e vijon ankimin e saj, por duke qenë se kjo pjesë e ankimit nuk lidhet me vlerësimin profesional të subjektit, por me marrëdhënien e punës midis denoncueses dhe të tij si zv/kryetar i gjykatës, Komisioni nuk do ta përfshijë në rezultatet e hetimit". Pra është e vërtetë që zonja {...}, duke e lexuar vendimin e mësipërm të KPK-së, ka paraqitur ankesa, KPK-ja ka shqyrtuar vetëm ato që lidhen me çështje specifike me qëndrimin si magjistrat dhe si gjyqtar në zgjidhjen e çështjeve të z. {...}, por jo me veprimtarinë e tij si zëvendësdrejtues i gjykatës.

Kërkesa për procedim e nisur nga ILD-ja lidhet me veprimtarinë e tij si drejtues i gjykatës. Faleminderit!

{...}: Mundem?

Ilir Rusi: Po zoti {...}!

{...}: Vendimi 541, e vërtetë është kjo që thotë znj. {...}, unë ju ftoj ta lexoni ose më lini pak kohë për të treguar që jo është marrë, por është marrë një për një, me problematikën e funksionimit të asaj gjykate. Ndoshta nuk është marrë në marrëdhëniet e punës, por për të gjitha rastet e tjera ajo është marrë. Se këtu po flasim për mbledhjen e Këshillit. Ç'lidhje kanë këtu marrëdhëniet e punës, zonja {...}? A po flasim për mbledhjen e Këshillit këtu?

Joana Asmi: Sigurisht.

{...}: Ç'lidhje ka këtu pastaj marrëdhënia e punës? Pra është marrë që çke me të. Bile është marrë me shumë gjëra domethënë... Por këtu tregon që unë di edhe shumë gjëra të tjera... Kjo tregon që këtu po mbështesim njëri-tjetrin, pasi në dijeninë time, zotit anëtar të KPK-së po i krijohet problem për vendimin. Unë jam shkarkuar, zotërinjë të KLGJ-së, përse nuk kam firmosur procesverbalin elektronik të seancave. E keni në vendim. Në dijeninë time është bërë problem ky vendim i imi, dhe tani për të mbajt njëri-tjetrin, vijnë me këto procese tërësisht tendencioze. Unë jam shkarkuar... në qoftë se unë po ju... përse nuk kam firmosur procesverbalin elektronik të seancave gjyqësore. Kur është vendimi unifikues i 2016, i 2015; kur është një udhëzim i qartë i Ministrit të Drejtësisë, e me radhë e me radhë. Prandaj po them, duke qenë se është bërë një problem, në dijeninë time, i këtyre anëtarëve, për këtë vendim tërësisht të padrejtë... unë jam shkarkuar edhe për pasurinë e babait, në '94, unë kam qenë 7 vjeç. Tani ka ardh për ndihmë ILD-ja, për të mbështetur këta persona politikë, me pushtet shumë të madh, që kanë kapur të dy.. (e paqartë fjala e gjyqtarit), që kanë influencë tek këta dy organe, dhe jemi përpara kësaj gjendjeje. Faleminderit!

Ilir Rusi: Ju faleminderit!

Marçela Shehu: Mund të them diçka?

Ilir Rusi: Po, zonja Shehu!

Marçela Shehu: Ajo që thatë në fund zoti {...} është arsyeja e vërtetë që thotë që ndodhet pas gjithë kësaj historie? Sepse thatë që faktet që ju atribuohen në fakt janë sebepi, ndërsa arsyeja e vërtetë është diçka tjetër dhe ju nuk deshët të na lodhnit me historinë e vërtetë. Është kjo që ju thatë në fund apo ka një histori tjetër të vërtetë?

Ilir Rusi: Zoti {...}!

{...}: Faleminderit, zoti Zëvendëskryetar!

Unë jam i bindur që ky është sebepi.

Raste të tjera jam i bindur që edhe zonja {...}, domethënë kam një lloj përshtypje të brendshme, që e di arsyen e vërtetë.

Unë po ju jap një rast tjetër për ta treguar. Ju ndoshta jeni njoftuar për një vendim i ILD-së në datën 6 dhjetor apo 7 dhjetor, vendim pushimi, për një pushim hetimi. Në datën 3 apo 2 kam pas një çështje shumë të rëndësishme. Kam dhënë dorëheqjen nga ajo çështje shumë e rëndësishme. Në datën 21 filloi ky procedim. Pra, ajo që dua të them është që këtu nuk ka lidhje fare... thjesht të tregoni buonsens. Unë këtë i kam kërkuar edhe zotit {...} (gjyqtarit) kur erdhi për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit, të lutem na mbroni nga procedimet disiplinore tendencioze të ILD-së, sidomos gjykata administrative si Vlorë, ku zonja Ukperaj ka punuar, e di shumë mirë çfarë interesash janë, sidomos ai bregu i detit Vlorë, Dhërmi, Himarë. Unë i di edhe me emra konkretë kush është pas këtyre, si ka proceduar, si ka filluar. Bile anëtarët e KPK-së flasin edhe vetë. Se këtu është vend i... ata flasin vetë "jo s'e ke nga unë", -siç flasin rëndomë. Fakti që edhe ky koordinim që thotë që ja s'e ka marrë KPK-ja por e marrim ne, tregon shumëçka. Por gjithsesi unë e lë në vlerësimin tuaj për ta kuptuar këtë çështjen.

Ilir Rusi: Faleminderit, zoti {...}!

Nëse nuk ka pyetje apo diskutime të tjera, apo edhe ndonjë pyetje në mes jush (palëve), përfaqësueses së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe magjistratit {...}, atëherë ju ftoj të largoheni që ne të vazhdojmë vijimin e mbledhjes së sotme.

(Flet zoti {...} pa ndezur mikrofonin.)

Ilir Rusi: Në vijim të mbledhjes do dalin të gjitha këto përgjigje.

Faleminderit!

(Dalin nga salla e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së dhe magjistrati. Vijon mbledhja dhe diskutimi vetëm në prezencë të anëtarëve të Këshillit. Pas votimit të propozimit të relatorit për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit z.{...}, në detyrën e Zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 451, datë 15.06.2022 të KPKS-ë, propozim i cili miratohet unanimisht nga anëtarët prezent, rifillon mbledhja nëpërmjet platformës. Ftohen palët të futen në sallë për t'i komunikuar vendimmarrjen e Këshillit. Rifuten në sallën e mbledhjes përfaqësuesit e ILD-së dhe magjistrati.)

Ilir Rusi: Me palët prezent.

Vendim "Për pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit z.{...}, në detyrën e Zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë".

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 147, pika 1 dhe nenin 147/a, pika 1, shkronja "b" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 138 e vijues të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 86, shkronja "e" dhe 97, pika 1, shkronja "a" dhe pika 3, të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, mori në shqyrtim kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, që i përket: Kërkues: Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Subjekt i procedimit: z.{...}, në detyrën e Zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, Objekti i

kërkesës: 1. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z.{...}, në detyrën e Zëvendëskryetarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. 2. Propozimin e masës disiplinore “Vërejtje publike”.

Baza ligjore: Neni 102, pika 1, shkronja “g” dhe “gj”, neni 105, pika 1, shkronja “b”, dhe neni 107 i Ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Mbështetur në nenin 145, në lidhje me nenin 126, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, i Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 66, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, vendosi:

1. Pezullimin e procedimit disiplinor të filluar ndaj magjistratit z.{...}, gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, deri në marrjen formë të prerë të vendimit nr. 541, datë 15.06.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

2. Kundër këtij vendimi ligji nuk lejon ankim.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet subjekteve të procedimit disiplinor, magjistratit z.{...} dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit.

Me kaq e quaj të përfunduar mbledhjen e sotme, me vendimmarrjen përkatëse.

Ditë të mbarë!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor